



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE  
ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR  
SPECIJALIZOVANO TUŽILAŠTVO

**Numri:** KSC-BC-2020-07  
*Prokurori k. Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt*

**Vendos:** Paneli i përbërë prej gjykatësit të vetëm  
Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Pjesëmarrës parashtrues:** Prokurori i Specializuar

**Data:** 2 tetor 2020

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Përgjigje e Prokurorit ndaj parashtrimit të protokolluar KSC-BC-2020-07/F00030**

---

**Zyra e Prokurorit të Specializuar**

Jack Smith

**Mbrojtësi kujdestar për**

**Nasim Haradinajn**

Bastiaan Martens

## I. HYRJE

1. Gjykatësi i vetëm duhet të hedhë poshtë mocionin.<sup>1</sup> Mbrojtja e z. Nasim HARADINAJ ('Mbrojtja') nuk fakton parashtrimet e veta, nuk kupton fazën aktuale të procesit dhe injoron kornizën e themeluar në Ligj<sup>2</sup> dhe Rregullore.<sup>3</sup> Në kundërshtim me çfarë thuhet në Mocion, (i) z. HARADINAJ është informuar plotësisht për arsyet e arrestimit të tij; (ii) Dhomat e Specializuara ('DHS') kanë juridiksion mbi veprat penale sipas neneve 387, 388 dhe 392 të KPK-së;<sup>4</sup> (iii) ekziston dyshim i bazuar se z. HARADINAJ i ka kryer këto vepra penale; dhe (iv) mbajtja e tij e mëtejshme në paraburgim është e domosdoshme.

## II. PARASHTRIMET

### A. MBROJTJA ËSHTË INFORMUAR SI DUHET

2. Fletarrestimi<sup>5</sup> ka informuar në mënyrë të plotë z. HARADINAJ për arsyet e arrestimit të tij,<sup>6</sup> dhe i ka ofruar Mbrojtjes informacion të mjaftueshëm për të mundësuar ushtrimin e të drejtës së z. HARADINAJ që të kundërshtojë ligjshmërinë e arrestimit dhe kushtet e paraburgimit.<sup>7</sup> Kërkesa për arrestim dhe materiali mbështetës i plotë<sup>8</sup>, gjithashtu i janë vënë tashmë në dispozicion Mbrojtjes, dhe

<sup>1</sup> Paraqitja e parë, mocion paraprak për të hedhur poshtë akuzat dhe mocion për lirim të menjëhershëm, 29 shtator 2020, KSC-BC-2020-07/F00030 ('Mocion'). *Shih gjithashtu* transkript i paraqitjes së parë, 29 shtator 2020, fq.15 (që cakton afatin për përgjigje). Meqë Mocioni nuk përmban numra të paragrafëve (në kundërshtim me Udhëzuesin e Punës të Zyrës Administrative mbi dosjet dhe parashtrimet e protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-15, neni 30), ZPS ka bërë përpjeje të ndërlidhë parashtrimet e veta me paragrafin përkatës në çdo faqe.

<sup>2</sup> Ligji Nr.05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyren e Prokurorit të Specializuar, 3 gusht 2015 ('Ligji'). Çdo përmendje e termit 'nen' ose 'nene' u referohet neneve të Ligjit, përveçse kur specifikohet ndryshe.

<sup>3</sup> Rregullorja e Procedurës dhe e Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-03/Rev3/2020, 2 qershor 2020 ('Rregullorja'). Çdo përmendje e termit 'rregull' ose 'rregulla' i referohet Rregullors, përveçse kur specifikohet ndryshe.

<sup>4</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi Nr.06/L-074 (2019) ('KPK').

<sup>5</sup> Versioni i redaktuar publik i versionit të korigjuar të fletarrestimit për Nasim Haradinajn, 24 shtator 2020, KSC-BC-2020-07/F00012/A03/COR/RED ('Fletarrestim').

<sup>6</sup> Neni 41(4).

<sup>7</sup> Neni 41(2).

<sup>8</sup> Versioni i redaktuar konfidencial i "Kërkesë URGJENTE për fletarrestime dhe urdhrat përkatës", parashtrimi i protokolluar KSC-BC-2020-07/F0009 i datës 22 shtator 2020, KSC-BC-2020-07/F00009/CONFRED, 1 tetor 2020, me dy shtojca publike ('Kërkesë për arrestim'). *Shih gjithashtu*

riklasifikimi i mëtejshëm është në vijim e sipër.<sup>9</sup> Përderisa parashtrimet e Mbrojtjes janë bazuar në dispozita të pazbatueshme si pasojë e parashtrimit apo konfirmimit të një aktakuze, ato duhet të hidhen poshtë menjëherë.<sup>10</sup>

#### B. DHOMAT E SPECIALIZUARA KANË JURIDIKSION MBI VEPRAT PENALE

3. Nenet 6(2) dhe 15(2)<sup>11</sup> përcaktojnë se Dhomat e Specializuara kanë juridiksion mbi vepra të caktuara penale të ndërlidhura me administrimin e drejtësisë, edhe sipas neneve 387, 388 dhe 392 të KPK-së.<sup>12</sup> Meqë nenet 6(2) dhe 15(2) përcaktojnë se vepra të tilla penale duhet të jenë të ndërlidhura me procedurat zyrtare dhe zyrtarët e DHS-së/ZPS-së<sup>13</sup>, juridiksioni i përkohshëm mbi krime të tilla domosdoshmërisht shtrihet përtej periudhës kohore të përcaktuar në nenin 7.<sup>14</sup>

#### C. EKZISTON DYSHIM I BAZUAR SE Z. HARADINAJ KA KRYER VEPRA PENALE

4. Faktet në këtë çështje janë të qarta dhe bazohen në veprime dhe sjellje të drejtpërdrejta, të kryera së fundmi, të vetë z. HARADINAJ. Parashtrimet e Mbrojtjes ku kërkohet të hidhen poshtë akuzat<sup>15</sup> keqinterpretojnë informacionin e paraqitur në

---

Version publik i redaktuar i 'Kërkesë URGJENTE për fletarrestime dhe urdhra përkatës', parashtrimi i protokolluar KSC-BC-2020-07/F0009 i datës 22 shtator 2020, KSC-BC-2020-07/F00009/RED, 1 tetor 2020, me dy shtojca publike.

<sup>9</sup> Transkripti i paraqitjes së parë, 29 shtator 2020, fq.18.

<sup>10</sup> *Shih, për shembull*, Mocion, KSC-BC-2020-07/F00030, fq.3, paragrafi i pestë (që i referohet nenit 21(6) dhe detyrimet e ZPS-së kundrejt të akuzuarit për nxjerrje të informacionit), fq.4, paragrafi i dytë (që u referohet mocioneve paraprake sipas rregullës 97), paragrafi i tretë (që i referohet parashtrimit të materialeve mbështetëse të aktakuzës dhe përmbledhjes përkatëse, siç është përcaktuar në rregullën 86(3)), fq.5, paragrafi i dytë dhe poshtëshënimi 8 (që i referohet nenit 39(2), i cili ka të bëjë me rishikimin e aktakuzës), fq.8 (ku kërkohen materialet mbështetëse të aktakuzës). *Shih* rregullën 86(6)(a) (një person merr statusin e 'të akuzuarit' vetëm pas konfirmimit të aktakuzës kundër tij/saj).

<sup>11</sup> *Shih po ashtu* nenin 16(3).

<sup>12</sup> Në kundërshtim me Mocionin, KSC-BC-2020-07/F00030, fq.2, paragrafi i parë, i dytë, i gjashtë, i shtatë dhe i tetë, fq.8. Mbrojtja gabon kur thekson se neni 6 nuk përcakton juridiksionin mbi nenin 387 të KPK-së, lidhur me frikësimin gjatë procedurës penale. *Shih* Mocion, KSC-BC-2020-07/F00030, fq.6, paragrafi i dytë. Fletarrestimi (*shih* KSC-BC-2020-07/F00012/A03/COR/RED, fq.1) dhe kjo përgjigje (*shih* shënimin4 lart) i referohen KPK-së së vitit 2019. Nenet 387, 388 dhe 392 të KPK-së kanë qenë përkatësisht me numër 395, 396 dhe 400, në Kodin Penal të Kosovës të vitit 2012, No.04/L-082 (siç përmenden në nenet 6(2) dhe 15(2)).

<sup>13</sup> Zyra e Prokurorit të Specializuar në këtë parashtrim të protokolluar përmendet si 'ZPS'.

<sup>14</sup> *Contra* Mocion, KSC-BC-2020-07/F00030, fq.6, paragrafi i tretë.

<sup>15</sup> *Shih* Mocion, KSC-BC-2020-07/F00030, fq.2, paragrafi i tetë.

fletarrestim dhe nuk largojnë dyshimin e bazuar se z. HARADINAJ ka kryer, apo ka bërë përpjekje që të kryejë veprat penale të frikësimit gjatë procedurës penale (Neni 387 i KPK-së), hakmarrjes (Neni 388 i KPK-së) dhe shkeljes së fshehtësisë së procedurës (Neni 392 i KPK-së).<sup>16</sup> Me gjithë pretendimet e kundërta të Mbrojtjes,<sup>17</sup> fletarrestimi përshkruan sjelljen përkatëse që përmbush elementët e këtyre veprave penale dhe ofron detaje specifike lidhur me datat, ngjarjet dhe informacionet e shpërndara në mënyrë të kundërligjshme.<sup>18</sup> Siç është bërë e ditur më lart,<sup>19</sup> që nga parashtrimi i protokolluar i Mocionit janë ofruar informacione shtesë, duke përfshirë informacionin në kërkesën për arrestim dhe shtojcat shoqëruese<sup>20</sup>.

5. Më tej, në fletarrestim është specifikuar se sjellja e kundërligjshme e z. HARADINAJ kishte lidhje me punën e ZPS-së.<sup>21</sup> ZPS-ja është përgjegjëse për hetimin dhe ndjekjen penale të personave që janë përgjegjës për krimet brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara; hetime dhe ndjekje të tilla penale përbëjnë procedura penale sipas neneve 387 dhe 392 të KPK-së.<sup>22</sup> Rrjedhimisht, parashtrimet e Mbrojtjes se fletarrestimi nuk ka specifikuar procedurën penale përkatëse, janë të pabazuara.<sup>23</sup>

6. Së fundi, Mbrojtja gabimisht mbështetet në nenet 40-44 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ('Kushtetuta') duke u përpjekur të shfajësojë sjelljen e kundërligjshme të z. HARADINAJ.<sup>24</sup> Liritë e shprehura në këto nene janë objekt i kufizimeve të domosdoshme në përputhje me ligjin, përfshirë ato për parandalimin e trazirave dhe krimit, parandalimin e nxjerrjes së informacioneve të pranuar në mirëbesim, apo ruajtjen e autoritetit dhe paanshmërisë së gjyqësorit.<sup>25</sup> Hetimet dhe ndjekja penale e krimeve, duke përfshirë veprat penale sipas neneve 387, 388 dhe 392

<sup>16</sup> Fletarrestim, KSC-BC-2020-07/F00012/A03/COR/RED, paragrafët 1-3.

<sup>17</sup> *Shih* Mocion, KSC-BC-2020-07/F00030, fq.4, paragrafi i pestë dhe i gjashtë.

<sup>18</sup> Fletarrestim, KSC-BC-2020-07/F00012/A03/COR/RED, paragrafët 1-3.

<sup>19</sup> *Shih* paragrafin 2 lart

<sup>20</sup> *Shih, për shembull, Kërkesë për arrestim*, KSC-BC-2020-07/F00009/RED, Pjesa III(A), KSC-BC-2020-07/F00009/RED-A01, KSC-BC-2020-07/F00009/RED-A02.

<sup>21</sup> Fletarrestim, KSC-BC-2020-07/F00012/A03/COR/RED, paragrafët 1-3.

<sup>22</sup> Neni 35(1), (2)(g). *Shih gjithashtu Kërkesë për arrestim*, KSC-BC-2020-07/F00009/RED, poshtëshënimi 20.

<sup>23</sup> *Shih* Mocion, KSC-BC-2020-07/F00030, fq.4, paragrafi i pestë.

<sup>24</sup> *Shih* Mocion, KSC-BC-2020-07/F00030, fq.2, paragrafi i pestë.

<sup>25</sup> Kushtetuta, Neni 55; Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Nenet 10(2), 11(2).

të KPK-së janë kufizime të domosdoshme dhe proporcionale mbi, ndër të tjera, liritë e përcaktuara në nenet 40-44 të Kushtetutës.<sup>26</sup>

D. PARABURGIMI I Z. HARADINAJ ËSHTË I DOMOSDOSHËM

7. Për të njëjtat arsye si ato të përcaktuara në fletarrestim,<sup>27</sup> janë plotësuar kriteret sipas nenit 41(6) për paraburgimin e z. HARADINAJ.<sup>28</sup>

8. Në kundërshtim me parashtrimet e Mbrojtjes,<sup>29</sup> fletarrestimi ka përshkruar në mënyrë të duhur faktorët që shkaktojnë paraqitjen e ‘arsyeve të artikulueshme’ se (1) ekziston rreziku i arratisjes; (2) z. HARADINAJ do të pengojë ecurinë e procedurave penale, ndër të tjera përmes ndikimit mbi dëshmitarë, viktimë apo bashkëfajtorë; dhe (3) natyra e rëndë e veprës penale, apo mënyra ose rrethanat në të cilat është kryer dhe karakteristikat personale të Z. HARADINAJ, sjellja e tij në të shkuarën, mjedisi dhe kushtet në të cilat ai jeton ose rrethanat e tjera personale tregojnë rrezikun se ai do të përsërisë veprën penale ose do të kryejë një vepër penale që ai ka kërcënuar se do ta kryejë.<sup>30</sup>

9. Sjellja e z. HARADINAJ gjatë arrestimit dhe që nga arrestimi ka rritur rrezikun e arratisjes sipas nenit 41(6), të pengimit dhe kryerjes së veprave të tjera penale edhe para lëshimit të fletarrestimit. Në momentin e arrestimit, Z. HARADINAJ ka bërë gjithçka tjetër, pos që ‘ka bashkëpunuar[] plotësisht’, siç është thënë nga Mbrojtja.<sup>31</sup> Në fakt, Z. HARADINAJ në mënyrë aktive u përpoq t’u shmangej oficerëve të ZPS-së, në fillim me makinë e pastaj në këmbë. Pak pas arrestimit, Z. HARADINAJ ka qenë

<sup>26</sup> *Shih, ngjashëm, ICTY, Trial Chamber, Prosecutor v. Hartmann, IT-02-54-RR77.5-T, Judgment, 14 September 2009, paras 69-70; ICTY, Appeals Chamber, Prosecutor v. Hartmann, IT-02-54-R77.5-A, Judgment, 19 July 2011, paras 159-161, 19 korrik 2011, paragrafët 159-161.*

<sup>27</sup> Fletarrestim, KSC-BC-2020-07/F00012/A03/COR/RED, paragrafët 4-6. *Shih gjithashtu* Kërkese për arrestim, KSC-BC-2020-07/F00009/RED, paragrafi 11 dhe Pjesët III(B)-(D).

<sup>28</sup> *Contra* Mocion, KSC-BC-2020-07/F00030, fq.2, paragrafi i gjashtë, fq.3, paragrafi i dytë, i tretë dhe i katërt, fq.7, paragrafi i tretë dhe i pestë.

<sup>29</sup> *Shih* Mocion, KSC-BC-2020-07/F00030, fq.6, paragrafi i shtatë, fq.7, paragrafi i parë.

<sup>30</sup> Fletarrestim, KSC-BC-2020-07/F00012/A03/COR/RED, paragrafi 1-3. Në kundërshtim me parashtrimet e Mbrojtjes (*shih* Mocion, KSC-BC-2020-07/F00030, fq.7, paragrafi i dytë), rreziku i kryerjes së veprave të tjera penale shprehimisht shihet si arsye për paraburgim sipas nenit 41(6)(b)(iii).

<sup>31</sup> *Shih* Mocion, KSC-BC-2020-07/F00030, fq.6, paragrafi i katërt.

i zëshëm dhe demonstrativ. Në përputhje me deklaratat e mëhershme,<sup>32</sup> ai deklaroi se refuzonte arrestimin nga ZPS -ja sepse nuk i njeh Dhomat e Specializuara. Në paraqitjen e parë të tij para gjykatësit të vetëm, z. HARADINAJ gjithashtu theksoi se ai nuk i njeh Dhomat e Specializuara.<sup>33</sup>

10. Përfshirja e z. HARADINAJ në shpërndarjen e paautorizuar të informacionit konfidencial dhe jopublik në së paku tre raste në kohët e fundit demonstroi qartë rrezikun se ai do të ndëmarrë masa për të penguar procedurat dhe do të kryejë vepra të tjera penale.<sup>34</sup> Faktikisht, z. HARADINAJ publikisht ka deklaruar se do të vazhdonte me shpërndarjen e informacioneve konfidenciale dhe jopublike,<sup>35</sup> përkundër urdhrave të gjykatësit të vetëm që vërtetojnë natyrën e tyre konfidenciale dhe jopublike dhe që ndalojnë shpërndarjen e mëtejshme të paautorizuar.<sup>36</sup> Në këto rrethana, parashtrimet e Mbrojtjes se sekuestrimi i informacioneve të shpërndara në mënyrë të kundërligjshme ka eliminuar rrezikun e mëtejshëm të nxjerrjes së kundërligjshme të informacioneve sfidojnë logjikën.<sup>37</sup>

11. Mocioni gjithashtu nuk ka mundur të cenojë përfundimet e mëhershme se krahas arsyeve për të shmangur juridiksionin e Dhomave të Specializuara dhe për të penguar procedurat e tyre, z. HARADINAJ gjithashtu ka në dispozicion mjetet, motivin dhe mundësinë. Pavarësisht nga rroga personale e pretenduar e z. HARADINAJ dhe fondet e Organizatës së Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ('OVL-UÇK'),<sup>38</sup> përfundimet dhe parashtrimet e mëhershme lidhur me

---

<sup>32</sup> Fletarrestim, KSC-BC-2020-07/F00012/A03/COR/RED, paragrafi 5; Kërkesë për arrestim, KSC-BC-2020-07/F00009/RED, paragrafët 10, 13, 23.

<sup>33</sup> Transkript i paraqitjes së parë, 29 shtator 2020, fq.17-18.

<sup>34</sup> Fletarrestim, KSC-BC-2020-07/F00012/A03/COR/RED, paragrafët 5-6; Kërkesë për arrestim, KSC-BC-2020-07/F00009/RED, paragrafët 6-10, 22-25.

<sup>35</sup> Fletarrestim, KSC-BC-2020-07/F00012/A03/COR/RED, paragrafi 5; Kërkesë për arrestim, KSC-BC-2020-07/F00009/RED, paragrafët 10, 22.

<sup>36</sup> Fletarrestim, KSC-BC-2020-07/F00012/A03/COR/RED, paragrafi 6; Kërkesë për arrestim, KSC-BC-2020-07/F00009/RED, paragrafët 6-10, 22, 24. *Shih gjithashtu* Urdhër në lidhje me dokumente konfidenciale dhe jopublike, 25 shtator 2020, KSC-BC-2020-07/F00017/A01.

<sup>37</sup> *Shih* Mocion, KSC-BC-2020-07/F00030, fq.7, paragrafi i parë.

<sup>38</sup> *Shih* Mocion, KSC-BC-2020-07/F00030, fq.6, paragrafi i pestë.



rrjetin dhe burimet në dispozicion kryesisht bazohen në anëtarësinë e gjerë të OVL-UÇK-së, që për afërsisht vlerësohet se përfshin 40,000 anëtarë.<sup>39</sup>

12. Për më shumë, shtetësia suedeze dhe e Bashkimit Evropian e z. HARADINAJ<sup>40</sup> i mundëson atij udhëtimin edhe më lirshëm sesa po të kishte vetëm shtetësi kosovare, përfshirë edhe në juridiksionet e vendeve që nuk kanë marrëveshje ekstradimi me Kosovën.<sup>41</sup> Z. HARADINAJ gjithashtu do të kishte mundësinë të largohej nga Kosova përmes pikave kufitare ilegale.<sup>42</sup>

13. Në përgjithësi, rreziqet që paraqet lirimi i z. HARADINAJ, të shqyrtuara si të vetme apo së bashku, mund të trajtohen në mënyrë të efektshme vetëm në objektin e paraburgimit. Sjellja e Z. HARADINAJ në të kaluarën, siç është paraqitur më lart si dhe në kërkesën për arrestim dhe fletarrestim, demonstroi se garancitë e tij personale<sup>43</sup> janë të pamjaftueshme në garantimin e respektimit të çfarëdo kushti dhe në tejkalimin e rreziqeve konkrete të lirimit.<sup>44</sup> Në rrethana të tilla, lirimi, me apo pa kushte, nuk duhet të miratohet.<sup>45</sup>

### III. MJETI LIGJOR I KËRKUAR

14. Për arsyet e lartpërmendura, gjykatësi i vetëm duhet të hedhë poshtë Mocionin në tërësi.

**Numri i fjalëve (në origjinal): 1866**

/nënshkrim/

<sup>39</sup> Fletarrestim, KSC-BC-2020-07/F00012/A03/COR/RED, paragrafi 4; Kërkesë për arrestim, KSC-BC-2020-07/F00009/RED, paragrafi 19.

<sup>40</sup> *Shih* Mocion, KSC-BC-2020-07/F00030, fq.6, paragrafi i pestë dhe i gjashtë.

<sup>41</sup> Kërkesë për arrestim, KSC-BC-2020-07/F00009/RED, paragrafi 20.

<sup>42</sup> Kërkesë për arrestim, KSC-BC-2020-07/F00009/RED, paragrafi 20.

<sup>43</sup> *Shih* Mocion, KSC-BC-2020-07/F00030, fq.7, paragrafi i shtatë dhe i tetë.

<sup>44</sup> Mocioni në fakt thjesht vetëm ofron një listë të kushteve pa shtjelluar përshtatshmërinë e tyre apo si mund të lehtësojnë ato rreziqet ekzistuese. *Shih* Mocion, KSC-BC-2020-07/F00030, fq.7, paragrafi i shtatë dhe i tetë.

<sup>45</sup> *Shih, ngjashëm*, ICC, Appeals Chamber, *Prosecutor v. Gbagbo*, ICC-02/11-01/11-278-Red, Judgment on the appeal of Mr Laurent Koudou Gbagbo against the decision of Pre-Trial Chamber I of 13 July 2012 entitled "Decision on [...]", 26 October 2012, para.80.

/nëshkrim/

**Xhek Smith**

**Prokuror i Specializuar**

E premte, 2 tetor 2020

Në Hagë, Holandë.